

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI JURIDIK – PRISHTINË**  
**STUDIMET POSTDIPLOMIKE MASTER**  
**PROGRAMI: KONTRATAT DHE E DREJTA KOMERCIALE**



**TEMË MASTERI**

**Tema: Trajtimi teorik dhe praktik i moshës si kusht për lidhjen e martesës dhe martesat nën moshën madhore, problemet praktike**

**Mentori:**

**Prof. Asoc. Dr. Bedri Bahtiri**

**Kandidatja:**

**Fjolla Aliu**

*Prishtinë, 2023*

## ABSTRAKT

Mosha është kusht për lidhjen e martesës dhe është e rregulluar me dispozita ligjore. Synimi i këtij punimi master është që të trajtojë moshën si kusht për lidhjen e martesës sidhe lidhjen e martesës nën moshën madhore, fenomen ky mjaft shqetësues dhe i pranishëm në shoqërinë tonë.

Martesa nën moshën madhore përcaktohet si kurorëzim i dy personave, ku njëra apo të dy palët janë nën moshën 18-vjeçare.

Në kuadër të këtij vështrimi, po ashtu, punimi nxjerr në pah arsyet kryesore, të cilat shpjen deri te martesa nën moshën madhore si dhe problemet, të cilat shfaqen tek të rinjtë, të cilët zgjedhin të martohen nën këtë moshë.

Në këtë punim është bërë përpjekje që të bëhet gërshetimi i teksteve të autorëve vendorë dhe të huaj, hulumtimeve nga organizata joqeveritare që operojnë në vendin tonë, dhe nga organizata të huaja, të cilat kanë hulumtuar më në detaje këtë fenomen, si dhe diskutime nga konventa të ndryshme të botës.

Gjatë shtjellimit të punimit do të flitet edhe për procedurën e lidhjes së martesës nën moshën madhore, ku do të shohim edhe ndërlidhjen e organit kompetent QPS-Organit të Kujdestarisë me Gjykatën Themelore përkatëse.

Nisur nga objekti i studimit dhe i kërkimeve në punën e bërë për punimin e kësaj tema janë përdorur metoda cilësore, metoda sasiore, metoda hulumtuese, metoda demografike si dhe metoda e anketës.

**Fjalët kyçe:** *konventa, martesa, metoda, martesa nën moshën madhore, organizata.*

## **ABSTRACT**

Age it is considered a condition for marriage and it is regulated by legal provisions. The aim of this master's thesis is to treat age as a condition for marriage as well as marital status under the age of minority, this phenomenon is quite disturbing and present in our society.

Marriage under the age of minority is defined as the marriage of two persons where one or both are under the age of 18.

In overview, this paper also highlights the main reasons that leads to marriage under the age of minority as well as the problems that occur in the young age for people who choose to marry under this age.

In this paper, an attempt has been made to compile the texts of local and foreign authors, research from non-governmental organizations operating in our country, from organizations and foreigners who have researched this phenomenon in more detail as well as discussions from the convention of different parts of the world.

During the elaboration of the work, we will also talk about the procedure of underage marriage where we will also see the connection between the QPS- which operates with The Basic Court.

Based on the object of study and research in the work are used qualitative methods, quantitative methods, research methods, demographic methods and survey methods.

**Keywords:** *convention, marriage, method, marriage under the age of minority, organisation.*

